

VENDIM
Nr.1581, datë 3.12.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË
LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “EURON” SHPK, “KADRIA”
SHPK DHE “TEUTA KONSTRUKSION” SHPK, PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE “ORGJOST I RI”, “BELE 1”, “BELE 2”, “TOPOJAN 1” E
“TOPOJAN 2”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe bashkimit të shoqërive “Euron” sh.p.k., “Kadria” sh.p.k. dhe “Teuta Konstruktion” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Orgjost i ri”, “Bele 1”, “Bele 2” e “Topojan 1” e “Topojan 2”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha